

## RELACION SHPJEGUES

### PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

#### "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE DHE PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NË FUSHËN E KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE"

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Mekanizmi i shqyrtimit administrativ të ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje përbën një garanci procedurale themelore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të vendosur në kujdes alternativ dhe për llogaridhënien e strukturave vendore që administrojnë këtë shërbim. Ligji nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me qëllim përcaktimin e rregullave për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ka ngarkuar Këshillin e Ministrave me detyrimin e miratimit të një vendimi për këtë qëllim, në zbatim të nenit 35, pika 4, të këtij ligji.

Krijimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave përbën një risi institucionale në sistemin shqiptar të mbrojtjes së fëmijëve, që plotëson në mënyrë organike kornizën e Regjistrat Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje dhe forcon arkitekturën e garancive procedurale për fëmijët në kujdes alternativ. Ai përbën gjithashtu shprehjen konkrete të parimit kushtetues të gjykimit të rregullt ligjor të zbatuar në fushën specifike të mbrojtjes së fëmijëve, ku ankuesit shpesh janë vetë fëmijë ose persona në pozicione strukturore të cënueshme.

Projektvendimi ka si qëllim rregullimin e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe procedurën administrative për shqyrtimin e ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje, në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 92/2025. Për këtë qëllim, projektvendimi përcakton strukturën, përbërjen, kompetencat, procedurat dhe garancitë procedurale që do të ndjekë çdo Komision i ngritur në nivel bashkie.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet:

- garantimi i një mekanizmi të vetëm, të strukturuar dhe të unifikuar për shqyrtimin administrativ të ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje, duke shmangur fragmentimin dhe inkonsistencën e praktikave midis njësive të vetëqeverisjes vendore;
- sigurimi i mbrojtjes substanciale të interesit më të lartë të fëmijës, si parim qendror i çdo vendimmarrjeje që e prek, në përputhje me nenin 3 të Konventës së OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës;
- garantimi i së drejtës së fëmijës për t'u dëgjuar, në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e tij, në çdo procedurë që e prek, në zbatim të nenit 12 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës;
- garantimi i gjykimit të rregullt ligjor përmes parashikimit të afateve të qarta, procedurave të dëgjueshme, vendimeve të arsyetuara dhe mjeteve efektive të ankimit;
- sigurimi i pavarësisë dhe paanshmërisë së organit shqyrtues përmes përbërjes multidisiplinare të Komisionit dhe rregullave për konfliktin e interesit;
- forcimi i mekanizmave të llogaridhënies së strukturave vendore përgjegjëse për kujdesin alternativ në familje;

- integrimi i procedurës së ankesave me Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, duke garantuar gjurmueshmërinë dhe transparencën e plotë.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektvendim është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2026, në kuadër të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit nr. 92/2025.

Projektvendimi propozohet në funksion të zbatimit të drejtpërdrejtë të Ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", konkretisht në zbatim të nenit 35, pika 4, të këtij ligji, që përcakton detyrimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurën e shqyrtimit të ankesave në këtë fushë.

Projektvendimi është pjesë e një pakete të integruar të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit nr. 92/2025, që përfshin gjithashtu vendimin për Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje dhe aktet e tjera shoqëruese. Koherenca e këtyre akteve garanton arkitekturën institucionale të plotë të sistemit të kujdesit alternativ në familje.

Projektvendimi mbështet zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe është i harmonizuar me:

angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara, përfshirë Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), Konventën Europiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës, dhe Udhëzimet e OKB-së për Kujdesin Alternativ ndaj Fëmijëve (Rezoluta A/RES/64/142, 2009);

detyrimet e procesit të integritit europian, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 19 të acquis-it për Politikën Sociale dhe Punësimin dhe Kapitullit 23 për Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore; Agjendën Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës 2021–2026, e cila parashikon konsolidimin e mekanizmave të ankimit dhe llogaridhënies në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve; Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, që vendos forcimin e garancive procedurale dhe llogaridhënies si shtylla të reformës së shërbimeve sociale;

Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike, e cila parashikon konsolidimin e mekanizmave administrative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për të zvogëluar ngarkesën gjyqësore.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Miratimi i projektvendimit është i nevojshëm për të garantuar që çdo person që preket nga vendimet në fushën e kujdesit alternativ në familje të ketë në dispozicion një mekanizëm efektiv, të shpejtë dhe të specializuar të ankimit administrativ, përpara se të jetë i detyruar t'i drejtohet gjykatës administrative. Ky qëllim përgjigjet, nga njëra anë, parimit të nivelit më të ulët të zgjidhjes së mosmarrëveshjes (që favorizon zgjidhjen e shpejtë dhe me kosto të ulët brenda administratës), dhe nga ana tjetër, specifikës së fushës, ku vendimet prekin drejtpërdrejt

fëmijët në pozicione strukturalisht të cënueshme dhe kërkojnë vlerësim multidisiplinar (juridik, social, psikologjik).

Për këtë qëllim, projektvendimi përcakton përbërësit kryesorë organizativë dhe procedural të Komisionit, duke përfshirë:

- përbërjen kolegjiale dhe multidisiplinare të Komisionit me pesë anëtarë, duke përfshirë specialistë të shërbimeve sociale, juristë, psikologë ose specialistë të mbrojtjes së fëmijëve, dhe përfaqësues të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- rregullat për pavarësinë funksionale të Komisionit nga strukturat e tjera të bashkisë;
- mekanizmat e parandalimit të konfliktit të interesit dhe të zëvendësimit të anëtarëve në rast përjashtimi;
- procedurën e qartë të paraqitjes, regjistrimit dhe shqyrtimit të ankesës, me afate të caktuara;
- garancitë procedurale për ankuesin, përfshirë të drejtën e dëgjimit, të paraqitjes së provave dhe të arsyetimit të vendimit;
- rregullat e veçanta për dëgjimin e fëmijës, në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e tij;
- detyrimet e bashkëpunimit institucional me të gjitha strukturat e përfshira në sistemin e kujdesit alternativ;
- mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit profesional;
- lidhjen sistematike me Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

Efektet e pritshme nga miratimi i projektvendimit janë pozitive dhe substanciale, pasi krijohet një kuadër rregullator që mundëson:

- garantimin substancial të të drejtave të fëmijëve në kujdes alternativ përmes një mekanizmi efektiv kontrolli mbi vendimmarrjet administrative që i prekin ata;
- zvogëlimin e ngarkesës gjyqësore të gjykatave administrative, përmes zgjidhjes së shumicës së mosmarrëveshjeve në fazën administrative;
- rritjen e cilësisë së vendimmarrjes administrative të strukturave vendore, përmes ekzistencës së një mekanizmi rishikimi që i nxit ato të arsyetojnë dhe dokumentojnë më mirë vendimet e tyre;
- forcimin e koherencës institucionale midis strukturave vendore, qendrore dhe gjyqësore të përfshira në sistemin e kujdesit alternativ;
- rritjen e transparencës dhe besimit publik ndaj sistemit të mbrojtjes së fëmijëve;
- mundësimin e analizës sistematike të modeleve të mosmarrëveshjeve përmes regjistrimit në Regjistrin Elektronik, që do të ushqejë politikat e ardhshme me prova reale.

Për të siguruar zbatimin efektiv të këtyre objektivave, projektvendimi përcakton qartë:

- përbërjen institucionale të Komisionit dhe rolin e kryetarit të bashkisë në emërimin e anëtarëve;
- subjektet që kanë të drejtën e ankimit, përfshirë vetë fëmijën, përfaqësuesit ligjorë, familjet biologjike dhe kujdestare, organizatat joqeveritare dhe subjekte të tjera me interes legjitim;
- afatin prej 10 ditësh kalendarike për paraqitjen e ankesës nga marrja e vendimit;

- afatin prej 15 ditësh kalendarike për shqyrtimin dhe vendimmarrjen e Komisionit;
- strukturën e detyrueshme të vendimit përfundimtar, përfshirë bazën ligjore, analizën faktike, përfundimet dhe mjetet ligjore mbrojtëse;
- mjetet e ankimit gjyqësor ndaj vendimit të Komisionit;
- rolin e Sekretariatit dhe lidhjen me Regjistrin Elektronik;
- formularët tip të ankesës dhe të vendimit, si shtojca të bashkëlidhura.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe nenit 35, pika 4, të Ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë".

Projektakti është në përputhje të plotë me parimet kushtetuese të mbrojtjes së veçantë të fëmijëve (neni 54 i Kushtetutës), gjykimit të rregullt ligjor dhe të së drejtës për t'u dëgjuar (neni 42 i Kushtetutës); të drejtës për rehabilitim (neni 48 i Kushtetutës); barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 18); mbrojtjes së jetës private (neni 35), dhe synon zbatimin e parimit themelor të interesit më të lartë të fëmijës të sanksionuar në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës.

Projektvendimi është gjithashtu në harmoni me legjislacionin e brendshëm përkatës, përfshirë:

- Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", që përcakton parimet e përgjithshme dhe rregullat e procedurës administrative të zbatueshme në çdo procedurë administrative, përfshirë procedurën para Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave;
- Ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, që përcakton rregullat e ankimit gjyqësor ndaj vendimit administrativ;
- Ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i korrigjuar;
- Ligjin nr. 23/2026 "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publik";
- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

Në planin ndërkombëtar, projektvendimi mbështet zbatimin e:

- Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 7531/1991, veçanërisht nenet 3 (interesi më i lartë i fëmijës), 9 (ndarja e fëmijës nga familja), 12 (e drejta e dëgjimit), dhe 20 (kujdesi alternativ);

- Konventës Europiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijës (Strasburg, 1996), që përcakton standardet procedurale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurat administrative dhe gjyqësore;
- Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), veçanërisht neni 6 (e drejta për gjykim të rregullt) dhe neni 8 (e drejta për jetën familjare);
- Udhëzimeve të OKB-së për Kujdesin Alternativ ndaj Fëmijëve (Rezoluta A/RES/64/142, 2009), që përcakton standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në kujdes alternativ;
- Rekomandimit Rec(2011)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës "Për të drejtat e fëmijëve dhe shërbimet sociale e miqësore me fëmijën dhe familjen";
- Udhëzimeve të Këshillit të Europës për Drejtësinë Miqësore me Fëmijën (2010), që përbëjnë standardin europian për procedurat administrative dhe gjyqësore që përfshijnë fëmijë;
- Strategjisë së Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijës 2022–2027;
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 të OKB-së, veçanërisht Objektivit 16.2 për ndalimin e abuzimit dhe Objektivit 16.3 për aksesin e barabartë në drejtësi.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektvendimi në vetvete nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me një akt specifik të acquis-it të Bashkimit Europian, por kontribuon në mënyrë substanciale në forcimin e standardeve të mbrojtjes së fëmijëve dhe të garancive procedurale administrative në Republikën e Shqipërisë. Ai mbështetet në bindjen se një mekanizëm i specializuar dhe efektiv i ankimit administrativ përbën parakushtin substancial për zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës, në harmoni me kërkesat e acquis-it të BE-së dhe me detyrimet e tjera ndërkombëtare.

Përkatësisht, projektvendimi kontribuon në zbatimin e:

- Strategjisë së BE-së për të Drejtat e Fëmijës (2021–2024) dhe vazhdimësisë së saj, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me drejtësinë miqësore me fëmijën dhe mekanizmat e ankimit;
- Komunikatës së Komisionit Europian "Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave (2020–2025)", që përfshin fëmijët si kategori të veçantë me të drejta të forcuara procedurale;
- Direktivës 2012/29/BE për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, veçanërisht në pjesën që përcakton standardet për trajtimin e fëmijëve viktimë;
- Kapitullit 19 të acquis-it për Politikën Sociale dhe Punësimin, veçanërisht në pjesën që mbulon shërbimet sociale dhe mbrojtjen e të miturve;
- Kapitullit 23 të acquis-it për Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore, që mbulon mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe aksesin në drejtësi;
- Kornizës strategjike të BE-së për të drejtat themelore dhe Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, veçanërisht nenet 24 (të drejtat e fëmijës) dhe 47 (e drejta për një mjet efektiv dhe gjykim të rregullt).

- Republika e Shqipërisë, përmes këtij projektvendimi, përparon dukshëm drejt arritjes së këtij standardi europian dhe ndërton infrastrukturën e nevojshme institucionale për të mbështetur procesin e integritimit në BE.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përcakton organizimin, funksionimin dhe procedurën e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje dhe është strukturuar në një trup normativ të ndarë në kapituj, me përmbajtjen e mëposhtme:

### KREU I — DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 — Objekti. Përcakton fushën e zbatimit të vendimit, që përfshin: (a) organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në nivel bashkie; (b) procedurën administrative për shqyrtimin e ankesave; (c) rregullat për marrjen, arsyetimin dhe njoftimin e vendimeve; dhe (ç) garancitë procedurale për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 2 — Ngritja e Komisionit. Parashikon se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ngrihet pranë çdo bashkie, si organ kolegjal i qëndrueshëm administrativ. Përcakton kategoritë kryesore të vendimeve që shqyrton Komisioni, përfshirë: vendimet për përzgjedhjen, refuzimin ose largimin e familjeve kujdestare; vendimet për vendosjen, transferimin ose ndërprerjen e vendosjes së fëmijës; cilësinë dhe standardet e ofrimit të kujdesit; dhe çdo vendim tjetër administrativ që prek të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës. Komisioni ushtron funksionet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe rregullorja e brendshme e bashkisë përfshin rregulla për organizimin dhe funksionimin e tij.

Neni 3 — Përbërja e Komisionit. Përcakton se Komisioni krijohet me vendim të kryetarit/es të bashkisë dhe përbëhet nga 5 anëtarë: (a) një përfaqësues i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore në bashki; (b) një jurist nga njësia përgjegjëse për çështjet juridike; (c) një psikolog ose specialist për mbrojtjen e fëmijëve; (ç) një përfaqësues nga NJMF/NJVNR; dhe (d) një anëtar tjetër me ekspertizë në fushën sociale. Komisioni drejtohet nga përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore. Anëtarët nuk kanë të drejtë të delegojnë anëtarësinë ose të zëvendësohen, dhe ndryshojnë vetëm me vendim të kryetarit të bashkisë. Anëtarët në konflikt interesi përjashtohen nga shqyrtimi dhe zëvendësohen.

Neni 4 — Parimet e organizimit dhe funksionimit. Përcakton se Komisioni organizohet dhe funksionon në bazë të të gjitha parimeve të veprimtarisë administrative sipas Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi. Komisioni ushtron veprimtarinë në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, respekton procesin e rregullt ligjor dhe ka detyrimin për të dëgjuar fëmijën sipas moshës dhe pjekurisë.

Procedura e shqyrtimit të ankesës

Neni 5 — E drejta e ankimit. Përcakton subjektet që kanë të drejtë të paraqesin ankesë, përfshirë: vetë fëmijën që përfshihet në proceset e kujdestarisë alternative, përfaqësuesin ose përfaqësuesin ligjor të fëmijës, anëtarët e familjes aktuale/biologjike, anëtarët e familjes kujdestare, organizatat joqeveritare dhe subjekte të tjera me interes legjitim. Ankimi paraqitet brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit. Komisioni shqyrton çështjet vetëm

me kërkesë të palëve të interesuara, dhe fëmijët gëzojnë të drejtën e mbështetjes nga bashkia për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesës.

Neni 6 — Paraqitja dhe verifikimi paraprak i ankesës. Përcakton se për ankesat nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin, identitetin e ankuesit dhe rrethanat faktike. Ankesa mund të paraqitet në formë shkresore, elektronike ose drejtpërdrejt para Komisionit. Ankesat anonime nuk pranohen, me përjashtim të rasteve kur ka indicie për shkelje serioze. Për çdo ankesë krijohet dosje e posaçme dhe regjistrohet detyrimisht në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje. Komisioni, brenda 5 ditëve kalendarike nga regjistrimi, verifikon kompetencën, plotësimin e kushteve formale dhe merr vendim mbi pranimin e ankesës. Çdo shërbim lidhur me ankesat është pa pagesë.

Neni 7 — Shqyrtimi i ankesës. Përcakton se ankesa shqyrtohet brenda 15 ditëve kalendarike nga regjistrimi. Komisioni mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm, dëgjon palët dhe dëgjon fëmijën në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin. Komisioni ka kompetencë të kërkojë dokumentacion nga çdo strukturë e përfshirë, të kryejë këqyrje në vend, të marrë në pyetje çdo person të lidhur me çështjen dhe të kryejë seanca dëgjimore në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Përcakton edhe detyrimet e bashkëpunimit institucional me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF), Shërbimin Social Shtetëror, institucionet e sistemit të drejtësisë, institucionet arsimore dhe shëndetësore, ofruesit e shërbimeve dhe organizatat e shoqërisë civile. Mosdhënia e informacionit pa shkak të arsyeshem përbën shkak për fillimin e procedurave të shkeljeve ligjore.

Neni 8 — Mbledhja dhe vendimmarrja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Përcakton procedurat e brendshme të mbledhjes. Komisioni thirret në mbledhje nga kryetari menjëherë me regjistrimin e një ankese. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm të paktën 3 anëtarë, dhe vendimet merren me shumicë të anëtarëve të pranishëm, me votim të hapur. Në rast barazimi, vota e kryetarit është vendimtare. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, që nënshkruhet nga të gjithë anëtarët dhe përfshin diskutimet dhe votat kundër.

Neni 9 — Vendimmarrja. Përcakton se Komisioni merr vendim të arsyetuar me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike nga regjistrimi i ankesës, që përmban: (a) bazën ligjore; (b) analizën faktike; (c) përfundimet dhe vendimet; dhe (ç) mjetet ligjore mbrojtëse. Vendimi i njoftohet menjëherë (jo më vonë se 3 ditë kalendarike) ankuesit dhe palëve të interesuara, në formë shkresore ose elektronike. Vendimi hyn në fuqi pas njoftimit dhe regjistrohet në Regjistrin Elektronik.

Neni 10 — Ankimi ndaj vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Përcakton të drejtën e palëve për ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me legjislacionin për gjykimin administrativ në fuqi.

Struktura mbështetëse dhe garancitë

Neni 11 — Sekretariati. Përcakton se struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki luan rolin e Sekretariatit të Komisionit. Sekretariati siguron mbështetjen administrative dhe teknike: pranon dhe regjistron ankesat; administron dhe arkivon dokumentacionin; përgatit materialet për shqyrtim; njofton anëtarët dhe palët; mban procesverbalin; ndjek zbatimin e vendimeve; dhe siguron regjistrimin në Regjistrin Elektronik. Sekretariati përgatit raportime periodike mbi ecurinë e ankesave, që regjistrohen në Regjistrin Elektronik.

Neni 12 — Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave. Përcakton se të dhënat personale në procedurat e shqyrtimit trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave

personale. Aksesit kufizohet vetëm për personat e autorizuar. Anëtarët ruajnë sekretin profesional për çdo informacion të marrë gjatë procedurës. Shkelja e konfidencialitetit sjell përgjegjësi sipas legjisllacionit në fuqi.

Neni 13 — Ngarkimi për zbatim. Përcakton institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi.

Neni 14 — Hyrja në fuqi. Përcakton se vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

#### Shtojcat

Projektvendimit i bashkëlidhen dy shtojca operacionale që formësojnë në mënyrë të standardizuar zbatimin e tij:

- Shtojca nr. 1: Formulari tip i ankesës, që përmban të dhënat e ankuesit, cilësinë e tij, të dhënat e fëmijës, objektin e ankesës, përshkrimin, kërkesën, dokumentacionin shoqërues, mënyrën e njoftimit dhe deklaratën e ankuesit;
- Shtojca nr. 2: Formatit tip i vendimit të Komisionit të shqyrtimit të Ankesave, që përmban të dhënat e çështjes, përmbledhjen e rrethanave faktike, bazën ligjore, veprimet procedurale të kryera, vlerësimin faktik dhe juridik, vendimin, mjetet e ankimit, njoftimin dhe regjistrimin, si dhe nënshkrimet e anëtarëve.

Këto shtojca garantojnë unifikimin metodologjik të procedurës në të gjitha bashkitë e vendit dhe lehtësojnë regjistrimin sistematik në Regjistrin Elektronik.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), për monitorimin e zbatimit nga këndvështrimi i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe analizat tematike;
- Shërbimi Social Shtetëror, për mbështetjen metodologjike dhe konsolidimin e të dhënave kombëtare mbi ankesat;
- Drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për mbështetjen në nivel rajonal;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë), përmes kryetarit të bashkisë, për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, sigurimin e strukturës së Sekretariatit dhe garantimin e burimeve të nevojshme administrative;
- Strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, që luajnë rolin e Sekretariatit të Komisionit;
- Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) dhe Njësitë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVNR), për pjesëmarrjen në Komision dhe bashkëpunimin gjatë procedurës;
- Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, për mbikëqyrjen e funksionimit të Komisioneve.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është përgatitur nga drejtoria përgjegjëse për politikat e kujdesit shoqëror në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë".

Ky projektvendim u dërgohet për mendim institucioneve të mëposhtme: Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrinë të Shtetit dhe Kryenegociatorit, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektvendimi i propozuar nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

### **PROPOZUESI**

#### **MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

**EVIS SALA**

